



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1224/3 prot.

Tiranë më 15.10.2019

Lënda: Kthim përgjigje

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Tiranë

Zyra e Komisionerit ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj 3950 Prot., të datë 31.07.2019, nëpërmjet të cilës kërkohet miratimi për instalimin e sistemit të survejimit me kamera (CCTV), në Njësitë e Vlerësimit Bio-Psiko-Social, të krijuara pranë Qendrave Shëndetësore në Tiranë. Në shkresën tuaj sqarohet se njësitë e vlerësimit kanë të bëjnë me shërbimin e ri social-shëndetësor që do tu ofrohet qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe se krijimi i këtij sistemi vjen në dobi të garantimit të transparencës dhe krijimit të besueshmërisë gjatë procesit të intervistimit të personave me aftësi të kufizuara.

Nëpërmjet shkresës nr. 1224/1 Prot., datë 20.08.2019, Zyra e Komisionerit ka kërkuar informacione shtesë lidhur me procesin. Me shkresën tuaj nr. 3950 Prot., datë 25.09.2019, bëni me dije se për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe përpunimin e tyre sipas rregullave dhe përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, do të kërkonim pëlqimin e çdo individi të intervistuar lidhur me përpunimin e të dhënave, nëpërmjet një deklaratë të nënshkruar prej tyre. Të dhënat e regjistruara nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (kamera dhe mikrofon) do të jenë "video" dhe "zëri/audio" vetëm për subjektet e të dhënave "pacientë".

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është dhe sistemi i video-survejjimit (CCTV). Një sistem i tillë grumbullon dhe ruan të dhëna "imazhe-video" dhe "zëri/audio" të subjekteve të të dhënave të cilët janë prezent/aksesojnë ambientet të cilat janë nën fokusin e kamerave të këtij mjeti përpunimi. Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave personale "imazhe-video" dhe "zëri/audio" nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV), në kuptim të pikës 12 të nenit 3 të ligjit, konsiderohet përpunim të dhënash personale.

Përpunimi i të dhënave personale me anë të një sistemi video survejimi është i ligjshëm:

- a) Për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj të veçantë. (Në këto raste është e nevojshme që të respektohen dispozitat e ligjit në fjalë);
- b) Me pëlqimin e subjektit të të dhënave, por praktikisht kjo është e mundshme vetëm në raste shumë të kufizuara, atëherë kur identifikimi i një grup personash që janë brenda zonës së kamerës bëhet në mënyrë të qartë;

- c) Pa pëlqimin e subjektit por gjithnjë duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Udhëzimi i Komisionerit nr. 46/2017, përcakton nivelin e sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 19/2016 "Për masat shitesë të sigurisë publike" dhe si rrjedhojë, është i zbatueshëm për ato kontrollues të cilët janë subjekt i këtij ligji.

Referuar Kreut VII të Udhëzimit nr. 23/2012 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë", Ofruesit e Shërbimeve Shëndetësore mund të instalojnë sistem video-survejsimi (CCTV) dhe të përpunojë të dhëna imazhe video për qëllime sigurie në rast se është i domosdoshëm nga rrethanat, por pa kufizuar në mënyrë disproporcionale të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në dokumentin politik për personat me aftësi të kufizuara miratuar me VKM nr. 380/2019, janë parashikuar kriteret dhe procedurat të mjaftueshme lidhur me vlerësimin e zbatimit të kësaj politike.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se mjeti/mënyra nëpërmjet të cilit tentohet të garantohet transparencja (nëpërmjet mbikëqyrjes së këtyre ambienteve me sistemin e video-survejsimit) dhe krijimi i besueshmërisë gjatë procesit të intervistimit të personave me aftësi të veçanta, në Njësitë e Vlerësimit Bio-Psiko-Social, është jo proporcional.

Gjithashtu, instalimi i sistemeve të video-survejsimit (CCTV) dhe përpunimi i të dhënave imazhe-video nëpërmjet tij gjatë procesit të intervistimit të personave me aftësi të veçanta, do të cënonte dispozitat e parashikuara në nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit.

Për sa më sipër si dhe në zbatim të neneve 5, 6, 7, 29, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2012 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë" si dhe pikës 6 (Realizimi i objektivave) të VKM 380 datë 05.06.2019 për miratimin e dokumentit politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuara në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatim e tij", Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i një sistemi të tillë është jo proporcional për të arritur qëllimin (garantimin e transparencës dhe krijimit të besueshmërisë gjatë procesit të intervistimit të personave me aftësi të kufizuara).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

